



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 687/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Vjosa Gradinaj Mexhuani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "EL-Bau" shpk & Eing Com" shpk- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me nr. prokurimi 651-22-9140-2-2-1, iniciuar nga AK-Kuvendi Komunal Gjilan, me datën 18.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Hedhet si e palejuar**, ankesa e operatorit ekonomik "EL-Bau" shpk & Eing Com" shpk- Gjilan, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21. 11. 2022 me numër protokollit 687/2022 për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese", me numër të prokurimit: 651-22-9140-2-2-1, iniciuar nga (AK) – KK Gjilan, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, kurse Vendimi i AK për anulim të aktivitetit të prokurimit, **Vërtetohet**.

2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "EL-Bau" shpk & Eing Com" shpk- Gjilan, aprovohet si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën: 03.10.2022, Komuna e Gjilanit në cilësinë e AK-së, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese”, me numër të prokurimit: 651-22-9140-2-2-1.

Me datën 31.10.2022, AK ka publikuar Njoftimin për anulim.

Me datën 10.11.2022, OE “EL-Bau” shpk & Eing Com” shpk- Gjilan ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 21. 11. 2022, në OSHP OE ankues me të dhënat e cekura si më sipër, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të AK-së, me nr. 687/22 (nr. i protokollit).

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertet vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjnë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 01.12.2022, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- të refuzohet si e pabazuar ankesa e OE ankues, si dhe
- të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për anulim

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Gjilan, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave gjelbëruese”, me numër të prokurimit: 651-22-9140-2-2-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: Shërbime- Kontratë Kornizë, vlera e parashikuar e kontratës: 80 000,00 €.

AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datën 03.10.2022, ndërsa me datë 11.10.2022 ka publikuar *Formularin standard (B54) për korrigjimin e njoftimit të publikuar*.

Për këtë aktivitet të prokurimit, AK me datë 31.10.2022, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (B58) në Platformën Elektronike për Prokurim Publik.

Me datë 07.11.2022 OE “EL-Bau” shpk & Eing Com” shpk- Gjilan, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së.

Ndërsa, AK me datë 10.11.2022 ka nxjerrë Vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, duke vërtetuar Vendimin e AK-së lidhur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së (B58) të datë 31.10.2022. Rrjedhimisht kundër këtij Vendimi, me datë 21.11.2022 OE “EL-Bau” shpk & Eing Com” shpk- Gjilan, ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, sipas autorizimit 687/22, dhe në pajtim me nenin 114 të LPP-së, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe për të njëjtat i ka këto të gjetura dhe konstatime:

Eksperti shqyrtues i prokurimit, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore, dhe duke u bazuar në të gjeturat lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, konstaton si në vijim:

AK me datën 31.10.2022, ka publikuar B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, për anulimin e aktivitetit të prokurimit, Vendim i cili kontestohet nga parashtruesi i ankesës.

Fillimisht, kurdo që Autoriteti Kontraktues nxjerrë dhe publikon Formularin Standard B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, AK është i obliguar të veproj sipas nenit 43 të RRUOPP, “Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve”.

Eksperti Shqyrtues, konsideron se, në mënyrë që të evitohen shkeljet procedurale të Ligjit dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që në të njëjtën ditë të ngritë në platformën e prokurimit elektronik Formularin Standard B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe t'i njoftoj Operatorët Ekonomik me Letrat standarde përkatëse

AK – Kuvendi Komunal Gjilan, në arsyetimin e dhënë në Vendimin për Anulim, citojmë:

“1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit

të prokurimit.

AK - Kuvendi Komunal Gjilan bënë anulimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi që sipas procesverbalit të hapjes përmes platformës e-prokurimi ka konstatuar se oferta e dorëzuar nga ana e OE të e interesuar në këtë procedurë të prokurimit ka tejkalluar vlerën e parashikuar andaj AK merr vendim që ta anuloj këtë aktivitet. Nga Njësia Kërkuese është konfirmuar se nuk ka mjete të mjaftueshme për të vazhduar më tutje. AK do ti ndërmerr të gjitha masat dhe së shpejti do të inicoj aktivitet të ri për këtë natyrë”.

Eksperti Shqyrtues konsideron se, Autoritetit Kontraktues, në Formularin Standard B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, në arsyetimin e dhënë për Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ka ngatërruar vetëm referimin e nenit përkatës, sepse një situatë e tillë nuk i referohet paragrafit 1 dhe nën paragrafi 1.1 të nenit 62 të LPP-së, siç ka vepruar AK në rastin konkret, por një situatë e tillë parashihet me paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të nenit 62 të LPP-së.

Pra, sipas arsyetimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues, shihet se ka vetëm ngatërrim të nenit përkatës, andaj një situatë e tillë sipas arsyetimit të dhënë nga AK për Anulimin e kësaj procedure të prokurimit parashihet me paragrafin 2, nën paragrafin 2.1 të nenit 62 të LPP-së.

Sipas nenit 62 të LPP-së , paragrafi 2, nën paragrafi 2.1

"Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit", të cilët përcaktojnë si në vijim:

“Paragrafi 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”.

Pra, sipas dispozitave të lartcituara, Aktiviteti i prokurimit përfundon pa dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet e përcaktuara me nenin 62 të LPP-së, si dhe me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 44 të RRUOPP.

Vlen të theksohet se, Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë: 80 000,00 €,

Ndërsa,

Vlera e ofertës të OE ankues, sipas Proces verbalit të hapjes së Tenderëve është: 148 466,13 €

Andaj, konsideroj se, Vendimi për Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit nga AK është i bazuar, sepse Autoriteti Kontraktues gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit gjithmonë duhet ta mbajnë në mend qëllimin e këtij ligji të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së:

“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera

të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla”.

Eksperti Shqyrtues konstaton se, duke i marrë parasysh faktet dhe argumentet e lart cituara, OE ankues “EL-Bau” shpk & Eing Com” shpk- Gjilan, mund të konsiderohet si palë pa interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, për faktin se, edhe nëse lënda kthehet në ri shqyrtim, AK sipas paragrafit 2 të nenit 62 të LPP-së mund ta anulon këtë aktivitet të prokurimit mbi bazën se, oferta e OE ankues tejkalon vlerën e parashikuar në Njoftim për Kontratë.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertëve shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në këtë rast. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit. Prandaj parashtruesi i ankesës nuk mund ta ketë tani në këtë fazë statusin e palës me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të *dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit*. Mirëpo aktiviteti i prokurimit në rastin konkret ka përfunduar në kuptim të nenit 62. Në kontekstin e kësaj dispozite, Paneli detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi I ofruar nga OE ankues është shumë mbi vlerën e parashikuar të kontratës, e që ky fakt nuk ka mundur të mohohej as nga AK. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim po ashtu nenin 103, të LPP, sipas të cilit, “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se,

mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar ne këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin merititor të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 dhe 62 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe anulim të këtij aktivitetit të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerçiale, dhoma e shkalles se pare në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së KK Gjilan

1x1 OE- ve ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.